



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

Lënda: INFOMARCION

KËSHILILIT BASHKIAKE

Raportimi nga Policia Bashkiake mbi zbatimin e ligjshmeris në pfunksjon të veprimatris së sajë e përcaktuar nga ligji

Relacion Shpjegues i Policisë Bashkiake për periudhën Janar–Gusht 2025

Gjatë periudhës Janar–Gusht 2025, Policia Bashkiake ka vijuar angazhimin e saj për të garantuar rendin dhe sigurinë, përmirësimin e ambientit, trajtimin e ankesave të qytetarëve dhe mbështetjen e aktiviteteve kulturore dhe turistike në Bashkinë e Përmetit.

Një nga prioritetet kryesore gjatë kësaj periudhe ka qenë lirimi i hapësirave publike. Bazuar në vendimin e Kryeministrit për lirimin e hapësirave publike, Policia Bashkiake, në bashkëpunim me Policinë e Shtetit, ka ndërhyrë në terren për të liruar hapësirat e zëna padrejtësisht nga biznese apo qytetarë që kishin ndërtuar pa leje, ose kishin zaptuar rrugë, trotuare dhe ambiente të përbashkëta. Në secilin rast është kërkuar lirimi vullnetar i hapësirave, ndërsa në rast mosbashkëpunimi, janë zbatuar masa ligjore për të siguruar që hapësirat publike t'u përkisnin qytetarëve dhe komunitetit në tërësi. Ky proces ka vijuar në qytet dhe në fshatra dhe pritët të vazhdojë, duke qenë prezencë e përhershme e Policisë në terren. Veprimet e ndërmarra kanë kontribuar në kthimin e hapësirave publike tek qytetarët, përmirësimin e qarkullimit, dhe ndërgjegjësimin e komunitetit për përdorimin ligjor të hapësirave.

Një tjetër fushë ku Policia Bashkiake ka dhënë kontribut të rëndësishëm ka qenë trajtimi i kërkesave dhe ankesave të qytetarëve. Gjatë kësaj periudhe janë pranuar dhe trajtuar 47 ankesa dhe kërkesa nga Policia Bashkiake, nga të cilat janë zgjidhur plotësisht. Ky proces ka mundësuar adresimin e shqetësimeve të qytetarëve dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve publike, duke ndikuar drejtpërdrejt në mirëfunksionimin e komunitetit. Gjatë kësaj periudhe janë mbajtur 102 procs verbale për problematika të ndryshme.

Gjithashtu, Policia Bashkiake ka mbikëqyrur dhe koordinuar punime të vogla për largimin e mbetjeve inerte, duke përfshirë 123 leje gjatë periudhës Janar–Gusht. Këto veprime kanë

Policia Bashkiake ka vijuar të jetë pranë qytetarëve dhe aktiviteteve të ndryshme në Bashkinë e Përmetit, duke kontribuar në krijimin e një mjedisi më të sigurt, të pastër dhe të rregullt. Prezenca në terren, bashkëpunimi me qytetarët dhe respektimi i ligjit janë faktorë kyç për të siguruar që hapësirat publike të mbeten të lira, të aksesueshme dhe në shërbim të komunitetit.

Policia Bashkiake ka vijuar të jetë në mbështetje e drejtorive të tjera si ajo e urbanistikës për probleme të ndryshme si :

Sqarim kufijsh, matje për legalizim, sqarim/pezullim leje punimesh.

Si dhe mbështetje e zyrës së taksa tregjeve në çdo rast që kanë kërkuar.

I është dhënë ndihmë punonjësve të mirëmbajtjes gjatë kryerjes së punimeve.

Policia Bashkiake

Polic: Vilson Çajupi

